

V E N D I M
Nr.230, datë 21.8.2001

PËR SHPALLJEN E LISTËS SË DEPUTETËVE TË PARTISË DEMOKRATE, TË CILËT PËRFITOJNË NGA NDARJA E MANDATEVE PLOTËSUESE PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN PËR VITIN 2001

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e tij të datës 21.8.2001, me pjesëmarrjen e:

Ilirjan Celibashi	Kryetar
Gasper Kokaj	Zëvendëskryetar
Pandeli Varfi	Anëtar
Tomor Malaj	Anëtar
Maksim Shimani	Anëtar
Igli Toska	Anëtar

MORI NË SHQYRTIM ÇËSHTJEN ME:

Objekt: Për shpalljen e listës së deputetëve të Partisë Demokratë, të cilët përfitojnë nga ndarja e mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001.

Baza Ligjore: Neni 18 pika 4 të ligjit nr.8609 datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë".

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur:

KONSTATOI SE:

Partia Demokratë, në zbatim të neneve 81, 82 e 83 të Kodit Zgjedhor, në datë 4.6.2001, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve listën shumemërore të kësaj partie. Kjo listë është shqyrtuar dhe miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr.796, datë 5.6.2001 "Për regjistrimin e listës shumemërore të Partisë Demokratë, për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001".

Nga ndarja e mandateve plotësuese për deputetë, të cilët i përkasin një partie apo koalicionit të partive, në bazë të përqindjes që Partia Demokratë ka marrë në zgjedhjet për Kuvendin, llogaritet të marrë 6 deputetë nga numri i përgjithshëm i mandateve plotësuese. Në bazë të listës shumemërore të dorëzuar dhe të miratuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, përfitojnë nga kjo listë të gjithë kandidatët me numër rendor nga 1 deri në 6. Në kërkesën për depozitim të listës shumemërore Partia Demokratë ka përcaktuar se përzgjedhja e kandidatëve për listën shumemërore, bëhet mbi bazën e mesatares së përqindjeve të votave që merr secili kandidat, si dhe me atë të subjektit politik në zonën zgjedhore përkatëse. Nga zbatimi i kësaj formule, gjashtë kandidatët të cilët kanë përqindjen më të lartë të votave janë si vijon:

- Nard Ndoka, kandidat në zonën zgjedhore nr.3, me 10, 51%
- Jak Ndokaj, kandidat në zonën zgjedhore nr.44, me 9, 26%
- Qazim Tepshi, kandidat në zonën zgjedhore nr.29, me 8, 25%;
- Saimir Curri, kandidat në zonën zgjedhore nr.45, me 7, 70%;
- Dashamir Shehi, kandidat në zonën zgjedhore nr.38, me 7, 06%;
- Ilirian Berzani, kandidat në zonën zgjedhore nr.26, me 6, 83%;

PËR SA MË SIPËR:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 18 pika 4, të ligjit nr.8609, datë 8.5.2000 "Për Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë",

V E N D O S I:

1.Të shpallë listën e deputetëve të Partisë Demokratë, të cilët përfitojnë nga ndarja e

mandateve plotësuese për zgjedhjet për Kuvendin për vitin 2001, si vijon:

- Nard Ndoka
- Jak Ndokaj
- Qazim Tepshi
- Saimir Curri
- Dashamir Shehi
- Ilirian Berzani

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Zëvendëskryetari
Gaspër Kokaj

Kryetari
Ilirjan Celibashi